



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

Njoftim për vende të lira pune në institucionet arsimore parashkollore (Kopësht)

Mbështetur në VKB nr.647 datë 23.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, dhe ligjin nr.48 /2018 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar neni 17, Institucionet arsimore parashkollor (Kopësht) shpallin 3 vende të lira pune për mësues për arsimin parashkollor si më poshtë:

1.Kopështi “Hasan Koçi”

2.Kopështi pranë Shkollës 9 vjeçare “Artan Zeka”, Qerret, Njësia Administrative Katund i Ri

3. Kopështi pranë Shkollës 9 vjeçare “Shefqet Ndroqi”, Romanat, Njësia Administrative
Rrashbull

Kriteret që duhet të plotësojë kandidatja janë këto:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

dh) ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna.

e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit,(mësues parashkollor) përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

Të jetë pjesëmarrës në portalin “Mësues për Shqipërinë”

Afati për dërgimin e dokumentave është deri më datë 16.10.2020.

Takimi për përzgjedhjen e fituesve do të bëhet më datë 19.10.2020 ora 11⁰⁰, në ambjentet e Bashkisë.

Aplikuesit do të jene 10 vendet e para në portalin “Mësues për Shqipërinë” të shpallur tek faqja zyrtare e Bashkisë Durrës.

Aplikimi bëhet duke dërguar dokumentat dhe kërkesën për punësim pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.